



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KRYETARI

Nr. 864 .Prot.

Rrëshen, më 19.02 .2026

URDHËR

Nr. 110 Dt. 19.02 .2026

“PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMEVE NË SHËRBIMIN CIVIL SIPAS STRUKTURËS ORGANIKE AKTUALE TË BASHKISË MIRDITË PËR VITIN 2026”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Neneve 18 dhe 19 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar, të pikës II të VKM-së Nr.108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”. Vendimit nr.2, datë 08.01.2024, i ndryshuar me Urdhër nr.04.dt.08.01.2025 “Për miratimin e strukturës organike të Bashkisë Mirditë”. Vendimit nr.98.dt.10.12.2025, të Këshillit Bashkiak Mirditë “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe konfirmimin e Prefektit Qarkut Lezhë nr.1240/4, prot datë 22.12.2025, Vendimit të Këshillit Bashkiak Mirditë Nr. 97, datë 10.12.2025 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Mirditë për vitin 2026” konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë nr.1240/2., prot. Akteve nënligjore në fuqi për administrimin e njësive të vetëqeverisjes vendore,

URDHËROJ:

1. Miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbimin civil në Bashkinë Mirditë, për vitin 2026, sipas listës së mëposhtme të pozicioneve me kategoritë, klasat.

Pozicioni	Sipas kategorive	Vende të lira	Kategoria e pagës
Drejtor	Për kategorinë e mesme drejtuese	2	II - 2
Përgjegjës	Për kategorinë e ulët drejtuese	2	III - 2
Specialist	Për kategorinë ekzekutive	8	IV - 3

Bazuar në VKM nr. 305, datë 5.4.2017, Për disa shtesa në Vendimin nr.142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “PËR PËRSHKRIMIN DHE KLASIFIKIMIN E POZICIONEVE TË PUNËS NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE DHE INSTITUCIONET E PAVARURA”, të ndryshuar. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm në kategorinë ekzekutive janë, si më poshtë vijon:

- Shkenca juridike
- Shkenca ekonomike
- Shkenca ekonomike

- Shkenca shoqërore
- Shkenca sociale, politike, komunikimi, gjuhë-letërsi, gazetari, gjuhë e huaj.
- Shkenca inxhinierike
- Shkenca ekzakte

Pozicioni	Sipas kategorive	Vende të lira	Kategoria e pagës
Drejtor - Drejtoria burimeve njerëzore juridike dhe marrëdhënieve me qytetarët	Për kategorinë e mesme drejtuese	1	II - 2
Drejtor - Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksave	Për kategorinë e mesme drejtuese	1	II - 2
Përgjegjës - Sektori i zhvillimit të teritorit dhe aplikimit të lejeve	Përgjegjës sektori kategoria e ulët	1	III - 2
Përgjegjës - Sektori i arkiv protokollit	Përgjegjës sektori kategoria e ulët	1	III - 2
Specialist - Sektori juridik dhe prokurime	Kategoria ekzekutive	3	IV - 3
Specialist - Sektori i zhvillimit të teritorit dhe aplikimit të lejeve	Kategoria ekzekutive	1	IV - 3
Specialist - Sektori i planifikimit hartimit projekteve dhe monitorimit të investimeve	Kategoria ekzekutive	2	IV - 3
Specialist - Sektori i marrëdhënjeve me qytetarët eventeve dhe IT.	Kategoria ekzekutive	1	IV - 3
Specialist- sektori i tatim taksave nxitjes biznesit	Kategoria ekzekutive	1	IV - 3

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Njësia Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore, arkiv protokollit dhe sektori i marrëdhënjeve me qytetarët, eventeve dhe IT për publikimin e këtij plani, në portalin elektronik të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në këndet e publikimeve në Bashkinë Mirditë.
3. Sekretar i Përgjithshëm dhe Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të fillojnë kryerjen e procedurave të rekrutimit pas publikimit të këtij plani, konform ligjeve, vkm-ve dhe udhëzimeve përkatëse.
4. Ky urdhër hartohet në 3 kopje: për sekretarin e përgjithshëm, për burimet dhe për protokollin.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Njësia përgjegjëse
Viktor Gjoka

Sekretar i Përgjithshëm
Artur LAZRI

Artur Lazri

KRYETARI

Albert MËLYSHI

